

VENDIM

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i përbërë prej:

| | |
|-------------------|----------|
| Xhezair Zaganjori | Kryesues |
| Ardian Dvorani | Anëtar |
| Andi Çeliku | Anëtar |
| Medi Bici | Anëtar |
| Artan Zeneli | Anëtar |

në seancën gjyqësore të datës 26.09.2017, mori në shqyrtim çështjen administrative që i përket:

PADITËS: Mimoza Telegrafi

PADITUR: Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve

OBJEKTI: *Detyrimin e palës së paditur të më paguaj pagën e një viti pune për zgjidhje të menjëhershme dhe të pa justifikuar të kontratës së punës. Detyrimin e palës së paditur të më paguajë shpërblimin për vjetërsi në punë. Detyrimin e palës së paditur të më paguajë 3 paga mujore për mos respektim të afateve të njoftimit. Detyrimin e palës së paditur të më paguajë 2 paga mujore për mos respektim të procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës.*

BAZA LIGJORE: *Neni 143, 144, 145 dhe 155 të Kodit të Punës, neni 32, 106, 154/a të K.Pr Civile.*

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.3437, datë 03.04.2013 ka vendosur:

Pranimin pjesërisht të kërkesë padisë.

Detyrimin e palës së paditur Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve Tiranë të dëmshpërblejë paditësen Mimoza Telegrafi me 3 paga mujore për mosrespektim të afatit të njoftimit.

Detyrimin e palës së paditur Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve të dëmshpërblejë paditësen Mimoza Telegrafi me pagën e 8 muajve për zgjidhjen e menjëherëshme e të pajustificuar të kontratës së punës.

Detyrimin e palës së paditur Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve ti paguaj paditëses Mimoza Telegrafi shpërblimin për vjetërsi në punë me pagën e një 15 ditëshi mbi çdo vit pune të plotë, pra me 4 paga mujore llogaritur mbi bazën e pagës mujore prej 31.520 lekë që ka përfituar në momentin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës.

Rrëzimin e kërkesë padisë për pjesën tjetër të saj.

V E N D O S I:

Prishjen e vendimit nr.2446 datë 12.11.2013 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

Tiranë, më 26.09.2017

Nr. 31003-02406-00-2014 i Regj. Themeltar

Nr. 00-2017- 1543 i Vendimit (782)

Dixhitalizuar dhe Perpunuar nga Qendra për Çështjet e Reformimit Publik
www.infocip.org